



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 4 dt. 10.03.2014

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 10.03.2014, pasi shqyrtoi përshkrimin e projektit Linja 110 KV Ersekë-Përmet, diskutuar në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, për “Kërkesa e Operatorit të Sistemit të Trasmetimit, për ndërtimin e linjës 110 kV, Ersekë-Përmet”.

VENDOSI:

1. Bazuar në nenin 47 të ligjit “Për trashëgiminë kulturore”, jepet miratim për fillimin e punimeve për Operatorin e Sistemit të Trasmetimit OST, për ndërtimin e linjës 110 kV, Ersekë - Përmet, duke respektuar të gjitha pikat e Vendimit nr. 282, dt. 11.02.2014, të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë.
2. Kryerja e të gjithë procedurave të realizohet nën supervizimin e Agjensisë së Shërbimit Arkeologjik.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike, për njoftimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI